A.K.P.A.
Nr 1066 Prot.
Datë,më 20 04 .2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT**
**AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**
**SHKOLLA E MESME PROFESIONALE KAMËZ**

Nr. 1020 prot. Kamëz, më,17/04/2026

**Lënda:** Njoftim për lëvizje paralele.

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE**
**DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN**
**AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr.759, dt.30.09.2024, i ndryshuar me Udhëzimin nr.4, datë. 18.08.2025 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit ",i ndryshuar me udhëzimin nr 4 datë 04.03.2026

Ofruesi publik i AFP-së, **Shkolla e Mesme Profesionale Kamëz**, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

- **1 mësues/e i kulturës profesionale formimi teoriko-praktik me kohë të plotë,** për drejtimin mësimor **Teknologji Informacioni dhe Komunikimi.**

**1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme**

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;

Adresa: Rruga "Montreal" Kamëz email: shkollaprofesionalek@gmail.com

f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

a) të ketë të paktën diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlefshme në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit publik tëAFP-së.
b) të ketë të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

**2.Dokumentet e aplikimit**

1. Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:
a) letërmotivimin për pozicionin;
b) jetëshkrimin (CV-në);
c) kartën e identitetit;
d) diplomën;
e) librezën e punës;
f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.
Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.
Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyera në gjuhën shqipe dhe noterizuara.
Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së brenda datës 27.04.2026

3.Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr.759,datë27.05.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit ", i ndryshuar .

**DREJTOR**
**Ornela LALA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE BUJQESORE
KAMEZ
TIRANE

Adresa: Rruga "Montreal" Kamëz
email: shkollaprofesionalek@gmail.com